



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 15 (pesëmbëdhjetë) vite - Objekti afarist i cili është i ndërtuar në Njësinë kadastrale P-01341-2, vendi i quajtur “Kriqë”, Tokë jo pjellore me sipërfaqe prej 940 m² oborr dhe 1650 m² objekt afarist, Zona Kadastrale Orllan

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, sipas vendimit nr.prot.01-947/03-0015797/24 të datës 04 mars 2024 për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme e Komunës - Objekti afarist i cili është i ndërtuar në Njësinë kadastrale P-01341-2, vendin e quajtur “Kriqë”, Tokë jo pjellore me sipërfaqe prej 940 m² Oborr dhe 1650 m² objekt afarist, Zona Kadastrale Orllan, në këtë përbërje:

1. **znj.Donjetë Sheqiri**, nga Kuvendi i Komunës
2. **z.Bahri Blakçori**, nga Kuvendi i Komunës
3. **znj.Adelina Stublla**, nga Ekzekutivi i Komunës
4. **z.Vigan Salihu**, nga Ekzekutivi i Komunës
5. **z.Shqipdon Rushiti**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-947/03-0015797/24 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës 04 mars 2024.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/05-0015804/24
Podujevë, datë, 04 mars 2024

